

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR 5832/S
DATE 31.10.2017



RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Auditimi i Pasqyrave financiare

Viti fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2016

“Partia Fronti i Majtë”

Adresë e deklaruar e pakonfirmuar: Rr. “Dibrës”, tek Selvia, Nr. 8, Tiranë

Subjekti - Partia Politike

Partia Fronti i Majtë

Adresa: Rr. "Dibrës", tek Selvia, Nr. 8, Tiranë

Audituar nga:

Marije DUSHI- Auditues ligjor, Partner

"FICADEX ALBANIA" SHPK

"Miqjoni" street, 117 Q. 4, Durrës - Albania;

Tel/fax - 355 32 37 859

Misioni

Auditimi i fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për vitin fiskal 2016

Raporti

Data 30 Tetor 2017

Versioni: Final

Deklaratë përgjegjësie

"Partia Fronti i Majtë", Parti Politike, për vitin 2016 ka deklaruar pasqyrat financiare në KQZ. Kjo Parti nuk është regjistruar dhe nuk ka dorëzuar PF në Tatime apo organizma të tjera, që të vërtetojnë aktivitetin ekonomik e financiar e saj si subjekt zgjedhor me status OJF.



"FICADEX ALBANIA" Ltd

Rruga " Migjeni", nr. 147 L. 4, Durrës - Albania

Mobile: + 355 69 29 52 787

Tel/fax : + 355 52 2 37 859

E-mail : mariadushi@gmail.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

Tiranë

Partia "Fronti i Majtë"

Tiranë

Opinionit kundër

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të rëndësishme siç janë përshkruar në paragrafin "*Bazat për dhënien e opinionit kundër*", pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Partisë "Fronti i Majtë" (PFM), si dhe fondet e përfuara dhe të shpenzuara për vitin fiskal që përfundon në 31 Dhjetor 2016, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar).

Me Vendimin Nr. 196 , datë 03 Maj 2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), i marrë në zbatim të kërkesave të Neni 23, pika "1" germa "a", të "Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015; neni 15/2, pika 2, germa c, neni 23/2, pika 2 dhe neni 23/3 të Ligjit 8580, datë 17/02/2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011, ligjin nr. 17/2014, datë 20.2.2014 dhe ligjin nr. 25/2014, datë 25.9.2014; si dhe Udhëzimi i KQZ-së Nr. 8, datë 25.03.2009 "për miratimin e kriterëve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e Audituesëve Ligjor (Ekspertëve Kontabël të Liçensuar) për auditimin e fondeve të përfuara dhe shpenzuara nga Partitë Politike" i ndryshuar, kemi lidhur kontratën Nr. 5484/29 Prot., datë 25.09.2017 me objekt: "Auditimi i fondeve të përfuara dhe të shpenzuara nga Partitë Politike për vitin fiskal 2016".

Bazat për dhënien e opinionit kundër

- 1) Pasqyrat financiare për vitin fiskal që përfundon me 31 Dhjetor 2016 të Partisë "Fronti i Majtë", të dorëzuara në KQZ nuk janë hartuar në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për OJF-të dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar).
- 2) Informacion shifror për fondet e përfuara nga tarifat e anëtarësimit për vitin 2016 nuk është dokumentuar rast pas rasti me emrat e kontribuesëve. Shpenzimet nuk janë analizuar sipas kategorive dhe nuk na u paraqit asnjë dokument vërtetues për qellimin e përdorimit të fondeve.
- 3) Deri në datën e raportit ne nuk morëm përgjigje nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë (DRTT) për kërkesën tonë nr. 11 Prot., datë 05.10.2017, me të cilën kërkohej të na informonte nëse Partia "Fronti i Majtë" është regjistruar në organet e tatimeve si detyrim i kërkuar nga neni 40, pika 4/4.1.a dhe neni 42, i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), dhe a ka dorëzuar pasqyrat financiare të vitit fiskal që përfundon më 31.12.2016, sipas kërkesave të nenit 29, ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 (i ndryshuar).



"FICADEX ALBANIA" Ltd

Rruga "Migjeni", nr. 147 L. 4, Durrës - Albania

Mobile: + 355 69 29 52 787

Tel/fax : + 355 52 2 37 859

E-mail : mariadushi@gmail.com

Nga ish financieri i Partisë u deklarua se Partia "Fronti i Majtë" nuk është regjistruar dhe nuk ka dorëzuar pasqyra financiare në organet tatimore.

- 4) Me postë, në datën 02.10.2017 dërguam kërkesën Nr. 10/2, prot. për të siguruar referenca kontakti (adresën e selisë së Partisë, të vendbanimit apo adresë tjetër të mundëshme, numër telefoni apo adresa e - maili). Letra na u kthye me shënimin: '... marrësi nuk është në adresë në kohën e dorëzimit, larguar, ndryshuar adresë...', gjë që nuk mundësoi kontaktimin me drejtimin e Partisë "Fronti i Majtë". Kontakti u bë i mundur me numrat e telefonit të saktësuar nga KQZ.

Ne nuk mundëm të kryejmë auditimin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më me detaje në seksionin e raportit tonë "përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare". Ne jemi të pavarur nga Partia në përputhje me Kodin e Etikës të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne nuk mundëm që të merrnim evidencë auditimi të mjaftueshme dhe e përshtatëshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësia e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në përputhje me SKK-të; "Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" i miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015; si dhe Ligjin Nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011; ligjin nr. 17/2014, datë 20.2.2014 dhe ligjin nr. 25/2014, datë 25.9.2014 dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Partisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion shpjegues, kur është e aplikueshme, çështjet që lidhen me vijimësinë duke përdorur bazën kontabël të vijimësisë nëse menaxhimi nuk synon likuidimin ose të ndërpresë operacionet, ose kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër realiste por vetëm të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Partisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat e auditimit tonë janë të marrim siguri të arësyeshme nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak mashtrimi apo gabimi, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të shkaktohen nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet në mënyrë të arësyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.



"FICADEX ALBANIA" Ltd

Rruga " Migjeni", nr. 147 L. 4, Durrës - Albania

Mobile: + 355 69 29 52 787

Tel/fax : + 355 52 2 37 859

E-mail : mariadushi@gmail.com

Një përshkrim i mëtejshëm i përgjegjësive tona për auditimin e pasqyrave financiare është përfshirë në shtojcën A të këtij raporti të auditorit, i cili gjendet në faqen nr. 3 në vijim.

Tiranë 30 Tetor 2017


REPUBLICA E SHQIPERISE
FICADEX
Albania
SHIPA E AUDITIMIT
Marije DUSHI - Partner
FICADEX ALBANIA SHPK
L. 4, Rr. Migjeni nr. 147, Durrës



"FICADEX ALBANIA" Ltd

Rruga " Migjeni", nr. 147 L. 4, Durrës - Albania

Mobile: + 355 69 29 52 787

Tel/fax : + 355 52 2 37 859

E-mail : mariadushi@gmail.com

Shtojca A

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare¹

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë auditimit.

Ne gjithashtu:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, përcaktojmë dhe kryejmë procedurat të auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e njafueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më e lartë se një që rrjedh nga gabimi, duke qenë se mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të duhurat për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.

Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël, nëse ka, dhe informacionet shpjeguese të lidhura të bëra nga drejtimi.

Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet e kryera dhe ngjarjet e ndodhura në një mënyrë që të arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne na kërkohet të komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mesin e çështjeve të tjera, qëllimin e planifikimit dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

¹ Në përputhje me standardet Ndërkombëtare të rishikuara të auditimit (SNA-të/ISAs)



Republika e Shqipërisë

Partia Fronti i Majtë

Rruga e Dibres Tek Se/via Nr.8 Tirane, Cel:067 31 44 007

Nr.22.rot.

Tiranë, më 30.03.2017

Lenda : Raporti Financiar per Vitin 2016

Drejtuar: *KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE*

Tirane

Bashkengjitur po ju dergojme pasqyrat financiare te vitit 2016.

Kryetari i Partisë Fronti i Majtë

Marko Dajti

Marko Dajti





Republika e Shqipërisë

Partia Fronti i Majtë

Rruga e Dibres Tek Selvia Nr.8 Tirane, Cel:067 31 44 007

Lënda: Raporti Financiar per Vitin 2016

KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Tirane

Pasqyrat financiare per vitin 2016

Të përgjithshme

Partia "FRONTI I MAJTË" – FM-ja, është një organizatë politike e pavarur e krijuar në konformitet të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Partia "Fronti i Majtë" është themeluar dhe rregjistruar në zyrën e Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.5236 datë 04.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është miratuar krijimi i Partisë "Partia e Punës e Shqipërisë e Riorganizuar" me iniciais "P.P.SH.R". Me vendimin nr.7981, datë 14.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është miratuar ndryshimi i emrit të partisë nga "Partia e Punës e Shqipërisë e Riorganizuar", me iniciais "P.P.SH.R" në "Partia Fronti i Majtë"
Kryetar i partisë është z.**Marko Dajti**

Organet drejtuese ne nivel qendror të partisë janë:

- Kongresi i anëtarësisë së Partisë
- Këshilli i Përgjithshëm i Partisë
- Kryesia e Partisë
- Kryetari i Partisë
- Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretarët e Partisë
- Komisioni i mbrojtjes Statutore



Burimet financiare te Partisë janë:

- Te ardhurat nga kuotizacionet.
- Te ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin për financimin e partive



Republika e Shqipërisë

Partia Fronti i Majtë

Rruga e Dibrës Tek Selvia Nr.8 Tirane, Cel:067 31 44 007

politike.

- Ndhimat dhe dhuratat e anëtarëve dhe përkrahësve të Partisë Fronti i Majtë.
- Ndhimat dhe dhuratat e organizatave partnere,
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

Selia e Partisë është në Tiranë në adresën "Rruga e Dibrës tek selvia nr.8" Tiranë.

Numri i anëtarëve të Partisë është mbi 3500 shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Financieri

Peparim Feimi





Republika e Shqipërisë

Partia Fronti i Majte

Rruga e Dibres Tek Se/via Nr.8 Tirane, Cel:067 31 44 007



BILANCI KONTABEL

Periudha 01.01.2016 – 31.12.2016

	Shenime	Vitraportues	Vili paraardhes
A	AKTIVET		-
I	Aktivët Afatshkurtra		-
	Aktive monedhere		-
	Derivative dhe aktive financiare te mbajtura per tre2.tim		-
	Derivativet		-
	Aktivët e mbajtura per tregtim		-
	Aktive te tjera afatshkurtra financiare		-
	Inventari	414,000	-
	Aktivët afatshkurtra te mbajtura per shitje		-
	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		-
	Totali per Aktivët Afatshkurtra	414,000	-
II	Aktivët Afatgjata		-
	Investimet financiare afatgjata		-
	Aktive afatgjata materiale		-
	Aktivët afatgjata materiale		-
	Kapital aksionar i papaguar		-
	Aktive te tjera afatgjata		-
	Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		-
	Totali i Aktiveve (I+ II)	414.000	-
B	Detyrimet dhe Kapitall		-
I	Detyrimet Afatshkurtera		-
	Huamarrjet	414,000	-
	Detyrime ndaj Shtetit ,sigurime shoqerore ,tat page talim burim		-
	Grant dhe te Ardhurat e Shtyra		-
	Provizione Afatshkurtera		-
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)	414.000	-
II	Detyrime Afatgjata		-



Republika e Shqipërisë

Partia Fronti i Majte

Rruga e Dibres Tek Selvia Nr.8 Tirane, Cel:067 31 44 007

	HuatAfatgjate ,kredi per automjete leasing		-	-
	Huamarrje tjera afatgjate		-	-
	Grantet dhe te ardhura te tjera te shlyra ose te cashcenzuara		-	-
	Totali IDetyrimeve Afatgjate (II)		-	-
	Totali IDetyrimeve (I+II)		-	-
III	Kapitali		-	-
	Kapitali i regjistruar (aksionar)		-	-
	Rezerva Statutore		-	-
	Rezerva Ligjore		-	-
	Fitime (humbje) te pashperndara		-	-
	Fitime (humbje) vitit financiar		-	-
	Totali IKapitali (III)		-	-
	TotaliDetyrimeve eKapitali(1,11,111)		414,000	-

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve

Nr.	Pershkrimi		Viti ushtrimor	Viti parardhes
				-
1	Te ardhura nga donator nen 10000 lek	754		-
2	Te ardhura nga donator mbi 10000 lek	755		-
3	Te ardhura donator media televizive	756		-
4	te ardhura te tjera, abonime, shitje il'aZete. interesa banko	782,788		-
5	Te ardhura l.12"nga kuota eanetaresisB	75	500,000	-
6	Te ardhura nea Buxheti I Shtetit	71	-	-
	Totali Ardhurave	641-648	500,000	-
1	Kosto e Punes		-	-
	1 Pagat	641	-	-
	2 Shpenzimet e Si: rurimeve Shoacore	644	-	-
2	Qera selie qendrore,	613	-	-
3	Shpenzime te tjera, telefon, internet, uj, enert l i elektrik.e	61-63	500,000	-
4	Amortizi.mi.		-	-
	Totali I Shpenzimeve (shuma 1-4)		-	-
			-	-
	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesit e kont.rolluara	761,661	-	-
2	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesmarriet	762,662	-	-
3	Te ardhura dhe shpenzime financiare		-	-
4	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare n0>1 invest afatgjat	763,765	-	-
5	Te ardhura dhe shpenzime nP"II interesat	767,667	-	-





Republika e Shqipërisë

Partia Fronti i Majte

Rruga e Dibrës Tek Selvia Nr.8 Tirane, Cel:067 31 44 007

6	Fitimet (humbiet) n°a kursit I kembimit	769,669			-
7	Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare	768,668			-
	Te ardhura te shvra per periudhen e ardheshme				-
	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin				-
	Te ardhurat e shtyra per periudhen e ardheshme				-

Financieri
Perparim Feimi

Pasqyra e Shpenzimet e kryera per vitin 2016 te detajuara si me poshte

Nr	Emertimi i Shpenzimeve Te vitit 2015	Shenime	Pages e lervorme	Detyrime te Paguara	Papaguara	Totali i Palletsave
-	Shoenzime Ooerative	A		416,000		416,000
-	Shoenzime telefonike		Banke	36,000		36,000
-	Per personelin paga shperblime eti		Banke			
-	Shoenzime te tjera		Banke			
-	Ener.rii Elektrike		Banke	48,000		48,000
-	Shpenzime , sherbime te tjera		Banke			
-	Shpenzime kancelari , karburant, material ndihmese		Banke			
-	Shpenzime bankare dhe interesa leasin2		Banke			
-	Shoenzime oostera , flamu, dekor		Banke			
-	Amortizimi ima.kines dhe pajisjeve te zvres					
1	Totali			500,000		500,000

Financieri

Perparim Feimi





Republika e Shqipërisë

Partia Fronti i Majtë

Rruga e Dibrës Tek Selvia Nr.8 Tirane, Cel:067 31 44 007

INVENTARI GJENDJE ME 31.12.2016

NR,	EMERTIMI	NJ.MATJES	SASI	CMIM	VLERA
1	Tavolina	cope	3	10,000	30.000
2	Karrike	cope	10	3.500	35.000
3	Kolltuk	cope	1	15.000	15.000
4	Kompiutera	cope	2	25.000	50.000
5	Printera	cope	2	7.000	14.000
6	Printer e fotokopje	cope	1	150.000	150.000
7	Dollape	cope	1	30.000	30.000
8	Etazher	cope	1	50.000	50.000
9	Kondicioner	cope	1	40.000	40.000
	Totali				414.000

Financieri

Perparim Feimi

Kryetari

Marko Dajti





"FICADEX ALBANIA" SHPK
L. 4, Rr. Migjeni nr. 147, Durrës Shqipëri

Tel + 355 52 2 37 859
Mob: +355 69 40 52787; +355 69 29 52 787

E-mail alficadex@gmail.com;
maridushi@gmail.com;

Për Partinë: "FRONTI I MAJTË"

Rruga Dibrës, tek Selvia Nr. 8, Tiranë

(Kopim nga "K. Dushi; Dylidhja e dokumentit, nr 7.)

Letër prezantimi

Drejtimit,

Në vijim të përmbushjes së kërkesave të vendimit nr. 196, datë 03.05.2017 të KQZ "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e audituesëve ligjor (Ekspertëve Kontabël të Liçensuar), të cilët do të kryejnë auditimin e Fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2016, Marije DUSHI me cilësinë e Audituesit ligjor (EKL) - Partner dhe administratorit të shoqërisë audituese "FICADEX ALBANIA" SHPK firmosi kontratën me Nr. 5484/29, Prot., datë 25.09.2017 me KQZ me objekt: "Auditimi i fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2016 për Partitë Politike ("PS").

Në këtë letër përcaktohet se afati i përmbushjes së misionit (dhënia e raportit) do të jetë jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i punës audit, ditë e cila do të jetë dita e dorëzimit të pasqyrave financiare dhe dokumentave e regjistra të kërkuara nga audituesi.

Ne do të donim të koordinonim punën me ju sa vijon:

- 1) Të biem dakord për datën e fillimit të punës, personin e kontaktit dhe dokumentacionin që do të dorëzohet.
- 2) Dokumentacioni i kërkuar nga ana jonë me listën jo përfundimtare bashkëngjitur.
- 3) Të biem dakord për letrat që do i dërgohen bankave, furnitorëve, kreditorëve të tjerë, Institucioneve financiare vendase kredidhënëse, kredidhënësve të huaj të rëndësishëm (marrveshje të huamarjeve), të cilat do të dërgohen me logon e Partisë suaj.
Për të përmbushur kërkesën e mësipërme sipas SNA, nga ju do të duhet të na vini në dispozicion (varianti elektronik dhe i printuar) për listat e klientëve, furnitorëve dhe kreditorëve të tjerë, etj...
- 4) Të biem dakord për letrën që do i dërgohet këshilltarit juridik (juristit), një përmbajtje e së cilës do ju dërgohet me e-mail me fillimin e punës. Me këtë letër do të kërkojmë informacion për konfliktet gjyqësore të lindura dhe të zgjidhura.
- 5) Të biem dakord për planin dhe programin e punës, si dhe me orët e punës.

Juaja sinqerisht!

Marije DUSHI - partner
"FICADEX ALBANIA" SHPK



Data _____

Jemi dakord me sa kërkohet
[Signature]
P/ Përfaqësues ligjor
[Signature]



Marije DUSHI - Senior Auditor
L. 4, Rr. Migjeni nr. 147 - Durrës Albania

Tel/fax + 355 52 2 37 859

E-mail alficadex@gmail.com;
mariadushi@gmail.com;

"FICADEX ALBANIA" SHPK
L. 4, Rr. Migjeni nr. 147 - Durrës Albania

LETËR ANGAZHIMI

Për auditimin e fondeve të përfuara dhe shpenzuara nga Partia gjatë vitit kalendarik 2016

KOMISIONI QENDROR ZGJEDHOR

Tiranë

Partia "FRONTI I MAJTË"

Rruga Dibrës, tek Selvia Nr. 8, Tiranë

Tiranë më 29 Shtator 2017

Objektivi dhe qëllimi i auditimit

Në zbatim të Vendimit nr. 196 , datë 03.05.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), i marrë në zbatim të kërkesave të Neni 23, pika "1" germa "a", të "Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015; neni 15/2, pika 2, germa c, neni 23/2, pika 2 dhe neni 23/3 të Ligjit 8580, datë 17/02/2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011, ligjin nr. 17/2014, datë 20.2.2014 dhe ligjin nr. 25/2014, datë 25.9.2014; si dhe Udhëzimi i KQZ-së Nr. 8, datë 25.03.2009 "për miratimin e kriterëve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e Audituesëve Ligjor (Ekspertëve Kontabël të Regjistruar/ Liçensuar) për auditimin e fondeve të përfuara dhe shpenzuara nga Partitë Politike" i ndryshuar, kemi lidhur kontratën Nr. 5484/29 Prot., datë 25.09.2017 me objekt: "Auditimi i fondeve të përfuara dhe të shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2016".

Kemi kënaqësinë që nëpërmjet kësaj letre t'ju konfirmojmë pranimin dhe marjen përsipër të këtij angazhimi, pasi nuk gjejmë pengesa në përputhje me kodin e etikës për audituesit ligjor dhe përcaktimet në Kodin Zgjedhor.

Ne do të kryejmë auditimin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më me detaje në seksionin në vijim "përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare". Ne jemi të pavarur nga Partia në përputhje me kërkesat etike që lidhen me auditimin tonë të pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Auditimi ligjor do të bëhet me objektivin që të mundësojë audituesin të shprehë një opinion profesional mbi sigurinë e arsyeshme se Pasqyrat Financiare për vitin kalendarik 2016 të Partisë "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", japin një pasqyrim të vërtetë dhe të ndershëm të Pozicionit Financiar të Partisë, të Fondeve të përfuara dhe të shpenzuara gjatë vitit (Pasqyrën e aktiviteteve) në përputhje me standardin kombëtar të kontabilitetit për OJF-të; "Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" i miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015; Ligjin Nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011, ligjin nr. 17/2014, datë 20.2.2014 dhe ligjin nr. 25/2014, datë 25.9.2014, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdon)

Siguria e arësyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të shkaktohen nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet në mënyrë të arësyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë auditimit.

Ne gjithashtu:


- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, përcaktojmë dhe kryejmë procedurat të auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më e lartë se një që rrjedh nga gabimi, duke qenë se mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të duhurat për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël, nëse ka, dhe informacionet shpjeguese të lidhura të bëra nga drejtimi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet e kryera dhe ngjarjet e ndodhura në një mënyrë që të arrijnë paraqitje të drejtë.
- Ne na kërkohet të komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mesin e çështjeve të tjera, qëllimin e planifikimit dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Auditimi përfshin vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe çmuarjet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, sikundër edhe vlerësimin për paraqitjen e përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Auditimi i pasqyrave financiare do të përfshijë teste të tilla dhe rishikim siç do të konsiderojë audituesi të nevojshme sipas rrethanave.

Vëmendje e veçantë do t'i jepet përcaktimit që:

- 1) Gjithë fondet publike të përfuara në zbatim të nenit 87 të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, janë dokumentuar sipas rregullave kontabël dhe janë përdorur në përputhje me kushtet e saktësuar në ligj,



"Përgjegjësitë e audituesit (vazhdon)

- 2) Gjithë fondet e përfuara nga personat fizik (përfshirë edhe shtetasit shqiptar me banim jashtë teritorit shqiptar) ose juridik janë marrë sipas përcaktimeve në nenin 89 të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" miratuar me ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, janë dokumentuar sipas rregullave kontabël dhe janë përdorur në përputhje me kushtet e saktësuara në ligj:

Informacion edhe për:

- a. Personat fizik ose juridik që kanë dhënë fonde janë persona vendas me banim brenda ose jashtë teritorit të RSH;
 - b. Shuma e dhuruar ose kundravlehtë në sende ose shërbime nga personat fizik ose juridik nuk është më e madhe se 1 (një) milion LEKE;
 - c. Se nuk janë marrë fonde nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme (përveç rastit kur aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike):
 - Neni 89/3.a - Ka përfuqur fonde publike, kontrata publike apo konçensione në 2 (dy) vitet e fundit me vlerë mbi 10 milion LEKE;
 - Neni 89/3.b - Ushtron veprimtari në fushën e medias;
 - Neni 89/3.c - Ka qenë partner me fondet publike në projekte të ndryshme;
 - Neni 89/3.ç - Ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.
- 3) Të gjithë dokumentat mbështetëse regjistri i posaçëm dhe llogaritë janë mbajtur në lidhje me gjithë aktivitetet.
- Rregjistri është plotësuar sipas përcaktimeve në nenin 90 të ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 (ndryshuar)
 - Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të lartë se 100 mijë LEKE janë bërë me llogari të pasaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Kjo llogari është e deklaruar jo më vonë se tre ditë sipas përcaktimit ligjor.
 - Shpenzimi total i Partisë, përfshirë dhe kandidatët e saj në fushatë nuk e kalon 10/fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marë nga fondet publike, sipas nenit 87/3 të Kodit zgjedhor.
 - Çdo shpenzim i bërë për fushatë është dokumentuar duke respektuar legjislacionin kontabël dhe tatimor në fuqi.

Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pamënjueshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar siç duhet dhe kryer në përputhje me SNA-të. Gjatë vlerësimit të rrezikut, ne do të vlerësojmë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrave financiare të Partisë tuaj me qëllim që të përcaktojmë ato procedura të auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Përgjegjësitë e drejtimit të përgatitjes e pasqyrave financiare

Auditimi ynë do të kryhet duke u bazuar në faktin që drejtimi dhe, kur është e përshtatshme, personat e ngarkuar me qeverisjen pranojnë dhe kuptojnë se ata kanë përgjegjësi:

- a) Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara të Partisë për vitin 2016 në pajtim me SKK për OJF-të dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (i ndryshuar) si dhe me ligjet dhe udhëzimet e KQZ.

Pasqyrat financiare të Partisë përbëhen nga:

- Pasqyra e Pozicionit Financiar
 - Pasqyra e Aktiviteteve
 - Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
 - Shënime shpjeguese dhe informacione të tjera shtesë të nevojshme mbi pasqyrat financiare të Partisë
- b) Për kontrole të brendshme të tilla që drejtimi i konsideron si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë nga mashtrimi ashtu edhe nga gabimi; dhe
- c) T'i japin audituesit:
- i. Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat *drejtimi* është në dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
 - ii. Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga *drejtimi* për qëllime të auditimit; dhe
 - iii. Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda entitetit nga të cilët gjykohet e nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, ne kërkojmë nga *drejtimi* dhe, kur është e përshtatshme, nga personat e ngarkuar me qeverisjen që të marrim prej tij konfirmime me shkrim lidhur me paraqitjet që do të na bëhen në lidhje me auditimin.

Pjesë integrale e kësaj letre është edhe plani audit dhe program i punës i buxhetuar.

Raportimi

Raporti i auditimit i përgatitur në përputhje me kërkesat e SNA-ve, do i paraqitet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) brenda 30 ditëve nga data e fillimit të punës audit.

Konkluzionet, opinionet dhe rekomandimet e kontrollit përgatiten për t'u përdorur nga drejtuesit e KQZ-së në të gjitha nivelet, dhe sipas vendimit të këtij të fundit edhe nga përdorues të tjerë të autorizuar.

Pavarësia

Në kohën e paraqitjes të një propozimi apo plan-veprimi për të kryer një kontroll, audituesit dhe manaxhimi i kompanisë audituese duhet të jenë dhe janë të pavarur nga çdo anëtar i drejtimit, nëpunës ekzekutiv apo drejtues i nivelit qendror rajonal apo lokal Partisë.

Pavarësia nënkupton që ortaku drejtues parësor dhe çdo pjesëtar stafi që do të përfshihet në këtë program nuk mund të jetë ose të ketë qenë ish-drejtues apo punonjes ekzekutiv në strukturat e Partisë, ose të ketë marrëdhënie personale, financiare apo biznesi me këtë subjekt politik.

Shpresojmë të kemi bashkëpunim të plotë me stafin e Partisë dhe besojmë se ata do të na vënë në dispozicion regjistrat, dokumentacionin dhe informacionin tjetër që kërkohet për kryerjen e auditimit.

Honoraret

Honoraret tona për misionin e lartpërmendur do të jenë: gjithsej orë pune me tarifë orare 3,000 LEKE, gjithsej LEKE (pa TVSH).

Konfidencialiteti

Konfidencialiteti i klientit (Partia). EKR do të ruajë natyrën konfidenciale të informacionit të marrë dhe diskutimet me klientin në përputhje me praktikën dhe politikat e vendosura nga ai.

Konfidencialiteti i raportit. Të gjithë produktet e punës që rezultojnë nga shërbimet e audituesit ligjor do të mbeten ekskluzivisht pronë e audituesit dhe që Klienti do të ruajë konfidencialitetin e formatit dhe përmbajtjes së çdo raporti, analize apo dokumenti tjetër të përgatitur nga ai.

Ju lutemi firmoseni dhe na dërgoni kopjen që i bashkëngjitet kësaj letre për të treguar se ajo është në përputhje me kuptimin tuaj për auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin kalendarik 2016.

Marije DUSHI - partner
FICADEX ALBANIA



Pranuar edhe në emër të KQZ
(Partia Politike - PS)

Emri: 

Pozicioni: